			
ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS KOSOVO DOCTORS CHAMBER LEKARSKA KOMORA KOSOVA			
Njësia: Unit:	ZK	Nr. Prot.:	292/2019
Jedësia: Sub-unit:		Prot. No.:	
Nr. i faqëve: No. of pages:	-15-	Data:	16.08.2019
Br. shtesës: No. of annexes:		Datum:	
Prijehje/ë			

ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

**Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorëve të pavarur
31 Dhjetor 2018**

Përmbajtja:

Raporti i auditorëve të pavarur	3
Pasqyra e të ardhurave gjithpërfshirëse	6
Pasqyra e pozitës financiare	7
Pasqyra e ndryshimeve në fonde	8
Pasqyra e rrjedhës së parasë	9
Shënimet e pasqyrave financiare	10-15

Raport i Auditorit të Pavarur

Drejtuar: Këshillit Drejtues të Odës së Mjekëve të Kosovës

Raport mbi Pasqyrat Financiare

Opinion i pakualifikuar

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të bashkëngjitura të Odës së Mjekëve të Kosovës (në vijim referuar si “Organizata” apo “OMK”) të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar të datës 31 dhjetor 2018, pasqyrën e të hyrave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e rrjedhës së parasë dhe pasqyrën individuale të ndryshimeve në fonde për vitin e mbyllur në këtë datë dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël si dhe informacionin tjetër shpjegues të përfshira në fq. 5-15.

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Organizatës më 31 dhjetor 2018, performancën e saj financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e përfunduar në atë datë në pajtim me Parimet e Përgjithshme të Pranueshme të Kontabilitetit

Baza për opinion të pakualifikuar

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në Përgjegjësitë e Auditorit në paragrafin për Auditimin e Pasqyrave Financiare të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEPK) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe ne kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.

Çështjet kryesore të auditimit

Çështjet kryesore të auditimit janë ato çështje që, sipas gjykimit tonë profesional, ishin të një rëndësie më të madhe në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale. Këto çështje janë trajtuar në kontekstin e auditimit të pasqyrave financiare në tërësi, dhe në formimin e opinionit tonë më sipër, dhe ne nuk do të japin një opinion të veçantë mbi këto çështje.

Ne kemi vendosur se nuk ka çështje të rëndësishme të auditimit për të komunikuar në raportin tonë.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe e atyre të ngarkuar me qeverisje për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe për ato kontrole të brendshme që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së kompanisë për të vazhduar aktivitetin e saj (parimi i vijimësisë), shpalosjen, sipas rastit, të çështjeve që lidhen me parimin e vijimësisë dhe përdorimin bazës së kontabilitet sipas parimit të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon të likujdojë Kompaninë ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë realiste përveç për ta bërë këtë. Ata që janë të ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të kompanisë.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, dhe për të nxjerrë raportin e një auditorit që

përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticismin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.


- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Ne gjithashtu, ju japim personave të ngarkuar me qeverisjen një deklaratë që ne jemi në pajtim me kërkesat përkatëse etike në lidhje me pavarësinë, dhe ju komunikojmë atyre të gjitha lidhjet dhe çështjet e tjera që mundet në mënyrë të arsyeshme, të ndikojnë në pavarësinë tonë, dhe kur është e zbatueshme, masat mbrojtëse përkatëse.

Nga çështjet e komunikuar personave të ngarkuar me qeverisjen, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishmet për auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe për pasojë edhe çështje kryesore të auditimit. Ne i përshkruajmë këto çështje në raportin tonë të auditimit përveç nëse në rastin kur ligji ose rregullat e ndalojnë bërjen publike të çështjes ose kur, në raste jashtëzakonisht të rralla, ne vendosim që çështja të mos komunikohet në raportin tonë për arsye se pasojat negative nga një komunikim i tillë pritet në mënyrë të arsyeshme të tejkalojnë përfitimet në favor të interesit publik.

Audit & Conto,


Elmije Osmani
Partner Angazhimi



14 Gusht 2019

Pasqyra e Pozitës financiare 2018

	Shënimi	Me 31 Dhjetor	
		2018	2017
Pasuritë			
Pasuritë jo-qarkulluese			
Prona, impiantet dhe pajisjet	3	5,384	5,363
Pasurit e patrupzuara		400	
		5,784	5,363
Pasuritë qarkulluese			
Stoqet, neto			
Llogarite e arketueshme dhe kërkesat tjera, neto			
Paraja dhe ekuivalentet e parasë	4	143,234	41
		143,234	41
Totali i pasurive		149,019	5,404
Ekuiteti dhe detyrimet			
Ekuiteti			
Kapitali dhe rezervat			
Teprica e Akumuluar		41	
Teprica e te hyrave mbi shpenzimet e vitit		145,080	41
Totali i ekuitetit		145,121	41
Detyrimet			
Detyrimet qarkulluese			
Llogarite e pagueshme dhe te tjera			
Te hyrat e shtyra	5	3,898	5,363
		3,898	5,363
Totali i detyrimeve		3,898	5,363
Totali i ekuitetit dhe detyrimeve		149,019	5,404

Këto pasqyra financiar janë aprovuar nga Menaxhmenti dhe Këshilli Drejtues i Organizatës me 15 Janar 2019 dhe autorizuar për publikim nga:

Financier

Znj. Pajtime Vllasa

Kryetari i OMK-së

Dr. Pleurat Sejdiu



Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse 2018

	Shënimi	Viti i përfunduar me 31 Dhjetor	
		2018	2017
Të hyrat operative			
Te hyrat	6	275,468	60
Te hyrat nga amortizimi I asetëve donacion		2,829	2,616
Fitimi bruto		278,296	2,676
(Shpenzimet) operative			
Shpenzimet e pagave dhe mëditjeve	7	(98,269)	
Shpenzimet e zhvlerësimit	3	(2,885)	(2,616)
Shpenzimet tjera operative	8	(32,063)	(19)
Total shpenzimet operative		(133,217)	(2,635)
Shpenzimet financiare			
Të ardhurat financiare			
Fitimi / (Humbja) para tatimit		145,080	41
Tatimi në fitim			
(Humbja)/Fitimi i vitit		145,080	41
Te hyrat tjera gjithëpërfshirëse neto nga tatimet			
Total te hyrat gjithëpërfshirëse për vitin		145,080	41

Pasqyra e rrjedhës se parasë 2018

	Viti që përfundon me 31 Dhjetor	
	2018	2017
Aktivitetet Operative		
Fitimi (Humbja) para tatimit	145,080	41
<i>Përshtatur për:</i>		
Te hyrat nga grantet		
Zhvlerësimin	2,885	2,616
Vlera neto e asetëve të shitura		
<i>Fitimi operativ para ndryshimeve në kapital punues</i>	147,964	2,657
<i>Ndryshimet në kapitalin punues:</i>		
Stoqet	0	
Të arkëtueshmet e tjera tregtare	0	
Detyrimet e tjera dhe tregtare	(1,465)	(2,358)
	146,499	299
Aktivitetet Investuese		
Blerja e pronës, impianteve dhe pajisjeve	(1,964)	
Investimet tjera	(1,342)	(258)
	(3,306)	(258)
Aktivitetet Financuese		
	0	0
Ndryshimet neto në para dhe ekuivalentët e parasë	143,193	41
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim	41	
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund	143,234	41

Pasqyra e ndryshimeve ne fonde 2018

	Kapitali aksionar dhe rezervat	Humbjet e mbajtura	TOTALI
	----- (në Euro) -----		
Gjendja me 1 Janar, 2017			
Transaksionet me pronarin			
Teprica e te hyrave mbi shpenzimet		41	
Te hyra gjithëpërfshirëse tjera			
Deponimet e kapitalit shtesë			
Total te hyra gjithëpërfshirëse			
Gjendja me 31 Dhjetor, 2017	0	41	41
Gjendja me 1 Janar, 2018	0	0	0
Transaksionet me pronarin			
Teprica e te hyrave mbi shpenzimet		145,080	145,080
Te hyra gjithëpërfshirëse tjera			
Deponimet e kapitalit shtesë			
Total te hyra gjithëpërfshirëse			
Gjendja me 31 Dhjetor, 2018	0	145,121	145,121

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

1. Të përgjithshme

Oda e Mjekëve të Kosovës është organizatë e pavarur profesionale e mjekëve që ushtrojnë veprimtari profesionale mjekësore në Republikën e Kosovës.

Është e themeluar nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë në bazë të LIGJIT Nr. 04/L-150 PËR ODAT E PROFESIONISTËVE SHËNDETËSOR

Fillet e para për themelimin e Odës së Mjekëve janë shënuar nga viti 2010. E gjitha ka filluar si iniciativë e Odës së Mjekëve të Gjermanisë, pasi është vërejtur mungesa e përfaqësimit profesional të mjekëve në evente ndërkombëtare të karakterit shëndetësor.

Inaugurimi i Odës së Mjekëve të Kosovës është bërë me datën 10 nëntor 2013, dhe gjithashtu zgjedhja e kryetares së OMK-s, Prof. Dr. Zylfije Hundozi. Kryetarja pas zgjedhjes së saj propozoi si zëvendës kryetarë të OMK-së, dr. n. Arben Grazhdani dhe dr. Rrezart Halili ku të dy propozime u votuan nga anëtarët e kuvendit. Në mes tjerash, në këtë ceremoni solemne kanë marrë pjesë edhe përfaqësuesit e Odave Mjekësore nga Gjermania, Austria, Hungaria, Kroacia, Mali i Zi, Maqedonia, Shqipëria dhe përfaqësues të lartë të misionëve diplomatike në Kosovë. Si mysafirë special kanë qenë të pranishëm edhe presidenti i Asociacionit Mjekësor Botërorë, dr. Otman Kloibe dhe zëvendës presidenti i Shoqatës Gjermane Mjekësore dhe njëherësh Kryetari i Odës së Mjekëve të Bavarisë, dr. Maks Kaplan.

Oda e Mjekëve të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: OMK-së) është organizatë e pavarur profesionale e mjekëve që ushtrojnë veprimtari profesionale mjekësore në Republikën e Kosovës.

OMK anëtareve të saj, i siguron standarde të larta të kodit të etikës dhe deontologjisë mjekësore, promovon dhe mbron veprimtarinë e profesionistëve shëndetësor në institucionet shëndetësore publike, private si dhe publiko-private, siguron edukimin e vazhdueshëm profesional me qëllim të ngritjes së performancës shëndetsore dhe ofrimit më cilësor të shërbimeve shëndetsore dhe shërbimeve tjera që kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor.

- Emërtimi i OMK -së është : Oda e Mjekëve të Kosovës (OMK).
- Selia e OMK-së është në Prishtinë.
- Akronimi “ OMK “ përdoret në gjuhët zyrtare dhe gjuhën angleze.

Anëtarësimi në OMK-ës është obligativ për të gjithë doktorët e mjekësisë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Republikën e Kosovës.

- Organet e OMK-së janë:
 - Kuvendi;
 - Kryetari i OMK-së;
 - Këshillidrejtues;
 - Këshilli mbikqyrës i OMK-së;
 - Këshilli etik;
 - Gjyqi i nderit;
 - Prokurori i OMK-së;
 - Komisionet e përhershme të OMK-së.

Mandati i anëtarëve të organeve të OMK-së është 4 vite me të drejtë të rizgjedhjes edhe për një mandat tjetër katër vjeçar.

Këshilli Drejtues i OMK-së ka njëmbëdhjetë (11) anëtar, nga të cilët një (1) anëtar i komunitetit jo shumicë dhe një (1) anëtar nga radhët e komuniteteve të tjera, Pesë (5) anëtarë të Këshillit Drejtues i zgjedh kuvendi i OMK-së nga radha e anëtarëve të vet, ndërsa tre (3) anëtar të Këshillit Drejtues i delegon Ministria e Shëndetësisë. Kryetari dhe zëvendës kryetarët e OMK-së janë anëtar të Këshillit Drejtues sipas detyrës zyrtare.

2. Bazat e përgatitjes dhe politikat e rëndësishme të kontabilitetit

2.1 Politikat e rëndësishme të kontabilitetit

a) Deklarata e përputhshmërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në pajtueshmëri me Parimet e Përgjithshme të Pranueshme të Kontabilitetit.

b) Bazat e përgatitjes dhe prezantimit

Pasqyrat financiare janë të prezantuara në Euro. Këto pasqyra financiare janë përgatitur në pajtueshmëri me konventën e kostos historike. Politikat e kontabilitetit janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme, dhe përveç nëse ceket ndryshe, ato janë të njëjtat me politikat aplikuar në vitin paraprak.

Periudha raportuese e organizatës është 12 muaj duke mbaruar me 31 Dhjetor të secilit vit. Pasqyrat Financiare janë përgatitur në baza krahasuese duke reflektuar bilancet e këtij vitit dhe të atij paraprak.

c) Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë bilancet e parasë së gatshme dhe ato të depozituara në bankat vendore.

d) Prona, impiantet dhe pajimet

Zërat e përfshirë në këtë kategori përfaqësojnë vetura, pajisjet e zyrës dhe pajisjet e teknologjisë informative dhe njihen si asetë vetëm kur është e mundur që:

- benefitet e ardhshme ekonomike të lidhura me asetin do të rrjedhin në Organizatë dhe
- kosto e asetit mundet të matet me besueshmëri.

Asetet fillimisht regjistrohen sipas koston. Kostoja përfshin të gjitha shpenzimet direkt të atribueshme në përvetësimin e zëri.

Organizata e mban asetet në kosto historike minus zhvlerësimi i akumuluar apo humbjet e akumuluar të demit, nëse ka. Zhvlerësimi i aseteve regjistrohet në baza vjetore duke përdorur metodën lineare dhe duke pas parasysh jetëgjatësinë e aseteve. Normat e aplikuar të zhvlerësimit janë:

- Veturat - 20 %
- Pajisjet tjera – 20 %
- IT – 30%

e) Grantet

Grantet janë njohur vetëm kur ka siguri të arsyeshme se:

- Organizata do të përmbushë të gjitha kushtet e bashkangjitura atyre; dhe
- grantet do të pranohen.

Grantet operative janë njohur si e hyrë përgjatë periudhës së nevojshme për ti lidhur ato me kostot, për të cilat janë menduar të kompensohen, në bazë sistematike. Grantet e shënuara për përvetësimin e pasurive janë shtyrë dhe njohur si e hyrë përgjatë kohës së përdorimit të pasurisë përkatëse.

f) Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme janë njohur kur shuma është e përcaktueshme dhe obligimi për të shlyer shumën ekziston si rezultat i operacioneve të Organizatës. Ato janë paraqitur në kosto.

a) Shpenzimet

Shpenzimet njihen në momentin kur ndodhin.

b) Valutat e huaja

Transaksionet në valuta të huaja janë regjistruar në pajtueshmëri me normën valide të këmbimit në datën e transaksionit. Ndryshimet janë regjistruar në pasqyrën e të ardhurave si fitime/humbje.

Në funde të vitit, bilancet e mbetura në valuta të huaja janë konvertuar duke përdorur kursin e këmbimit në ditën e fundit të periudhës raportuese. Fitimet apo humbjet nga këto këmbime janë njohur në pasqyrën e të ardhurave.

c) Tatimi në fitim

Organizata është e liruar nga tatimi në fitim.

d) Te hyrat & shpenzimet

Gjate kësaj periudhe, Organizata ka pranuar grante për të financuar aktivitetet dhe operacionet e projekteve. Grantet janë pranuar për projekte specifike të dorëzuara tek donatorët dhe të aprovuara prej tyre.

3. Prona dhe pajisjet

	Pajisje TI	Mobile për zyre	Inventar për zyre	Total
Me 01 Janar 2018				
Kosto	11,797	1,185	96	13,078
Shtesat gjate vitit	1,973	307	626	2,906
Shlyerja e Aseteve				0
Transferet e brendshme				0
Me 31 Dhjetor 2018	13,770	1,492	722	15,984
Zhvlerësimi i Akumuluar				
Me 1 Janar 2018	(7,018)	(647)	(50)	(7,715)
Zhvlerësimi i vitit	(2,456)	(287)	(142)	(2,885)
Shlyerja e Aseteve				0
Largimi i Aseteve				0
Me 31 Dhjetor 2018	(9,473)	(934)	(192)	(10,599)
Vlera neto ne libra 01 Dhjetor 2018	11,797	538	46	5,363
Vlera neto ne libra 31 Dhjetor 2018	4,297	558	530	5,384

4. Paraja dhe ekuivalentet e parasë

	Me 31 Dhjetor 2018	Me 31 Dhjetor 2017
Llogaritë rrjedhëse ne bankat vendore	143,234	41
Paraja në dorë		
	143,234	41

Oda e Mjekëve të Kosovës
Shënime për Pasqyrat Financiare me dhe për vitin që përfundon me 31 Dhjetor, 2018

5. Të hyrat e shtyara

	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2016
	(në EUR)	(në EUR)
Llogaritë e pagueshme	3,898	5,363
Totali i llogarive të pagueshme	3,898	5,363

Levizja e të hyrave të shtyera

	Me 31 Dhjetor 2018	Me 31 Dhjetor 2017
Te hyrat e shtyra-Asetet	5,363	7,721
Te marra gjate vitit	1,342	258
Te njohura gjate vitit	(2,807)	(2,616)
	3,898	5,363

6. Të hyrat

	Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor	
	2018	2017
Të hyrat nga Anëtarësia-Sektor i publik	171,215	
Të hyrat nga Anëtarësia-Sektor i privat	42,026	
Anëtarësimet e mjekëve të huaj-Sektor i privat	6,500	
Te hyrat nga licencimi dhe ri licencimi I mjekëve	41,884	60
Te hyra tjera	13,843	
Total te hyrat	275,468	60

7. Pagat dhe benefitet e personelit

	Viti që përfundon me 31 Dhjetor	
	2018	2017
Pagat për personelin e rregullt	42,233	
Mëditjet për Kuvendin	32,275	
Mëditjet për Këshille, Komisione dhe udhëtime zyrtare	19,109	
Kontributet pensionale	4,653	
Pagat Bruto	98,269	0

8. Shpenzimet tjera

	Viti që përfundon me 31 Dhjetor	
	2018	2017
Material shpenzues për zyrë	4,185	
Reprezentacioni	746	
Përkrahja e Shoqatave të Profesionistëve Shëndetësor	8,081	
Mbështetja e mjekëve për EVP	2,910	
Shpenzimet e telefonit	1,090	
Shpenzimet e postës	65	
Shpenzimet e transportit	215	
Hulumtime (sondazhe, anketa, fokus grupe)	1,991	
Faksimil	4,802	
Provizioni bankarë	558	19
Salla dhe pije për mbledhjen e Kuvendit	171	
Shpenzime tjera operacionale	4,250	
Mbështetje Financiare nga Fondi për Solidaritet	3,000	
Total shpenzimet tjera operative	32,063	19